



Policia konfiskon një armë zjarri në Vushtrri, i dyshuari lirohet në procedurë të rregullt



09/02/2023 08:56



Policia e Kosovës ka bërë të ditur se në orët e hershme të mëngjesit të sotëm ka konfiskuar një armë zjarri në Vushtrri.

Sipas njoftimit të policisë, konfiskimi i armës është bërë nga ana e policisë në kohën kur njësia policore kishte qenë në një pikë kontrolli dhe gjatë kontrollit të një automjeti me targa vendore, në automjet ishte gjetur një armë e llojit pistoletë dhe një karikator me pesë fishekë, shkruan [lajmi.net](#).

"I dyshuar P.R., i moshës 33-vjeçare është shoqëruar në Stacion dhe është intervistuar në cilësinë e personit të dyshuar. Arma dhe karikatori janë konfiskuar dhe janë proceduar si prova materiale", thuhet në njoftimin e policisë.

Pas konsultimit me prokurorin, i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt ndërsa ndaj tij është iniciuar rasti për dyshimin e kryerjes së veprës penale "Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve". [/Lajmi.net/](#)



Artikuj të ngjashëm




February 9, 2023

Kurti: Asociacioni është i kryetarëve të nderit Thaçi dhe Mustafa, për...



February 9, 2023

Haradinaj: S'duhet fajësuar Kurtin për Asociacionin – atë e trashëguam



February 9, 2023

Tërmet në Shqipëri



February 9, 2023

Mbrojtja e Salih Mustafës me njoftim për apel, Trendafilova e cakton panelin



February 9, 2023

Njeriu me shumë ndikim te Kurti shpërndan thirrje për protestë kundër...



February 9, 2023

Joseph Borell paralajmëron takimin e radhës Kurti-Vuçiq



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrya nr. 5

Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information

RRJETET SOCIALE

